



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

I shkurtër nga procesverbali i mbledhjes së 24-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 30.11.2023, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragaçina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Rustemi, nënkryetar i komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Elmaze Behluli, DA
8. Sead Aliu, DI
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DA
11. Safete Amerrlahu, DGJK
12. Burim Rustemi, DSHPMSh
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-LLugiqi
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit ,pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 23-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024
3. Diskutimi i raportit të planit të integritetit të Komunës së Lipjanit
4. Diskutimi i planit të veprimit të adresimit të rekomandimeve të ZKA-së
5. Diskutimi i raportit të auditorit të mbrëmshëm dhe planit të veprimit për adresimin në rekomandimeve.
6. Propozim vendim për caktimin e veprimeve të përkohshme për trajtimin e objekteve të mbyllura shkollore.
7. Propozim vendim për miratimin e planit orientues të punës së kuvendit të komunës së Lipjanit për vitin 2024

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka verjetje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Alban Salihu, tha se Gjykata Kushtesuese ka marr vendim qe neni 5-të i tatimit në pronë nuk cenon përgjegjësi komunale apo nuk zvogëlon të hyrat e komunës në kundërshtim të kushtetutës dhe legjislacionin e aplikueshëm, Andaj, duke u bazuar në këtë vendim, ne propozojmë që në rendin e ditës të shkohet edhe kjo pikë që do e bëhej falja e faturës së tatimit në pronë në vlerën prej 100 euro për secilin tatimpagues në komunën e Litjanit. Kërkoj që kjo pikë të votohet dhe të futet në rendin e ditës.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se në materialin qe e keni marr propozim vendim per normat tatimore ne faqen e 4-të e keni për vitin 2023 për ngarkesa tatimore për komunën tonë ka qenë 423 mijë,. Për vitin e ardhshëm 2024 është vetëm 150 mijë.

Arsim Jashari, tha se e pyes kryetarin, po më intereson, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka qenë për vitin 2023. Vendimi është për 2023, Unë atë që e kam parë që janë një lirue, e kam parë shumë mirë. A vlenë edhe për 2023, a vazhdojmë si komunë prej 2024?

Pastaj Kryesuesi e hudhi ne votim rendin e ditë së propozuar dhe pas votimit u konstatua se me 25 vota per dhe 4 kunder u aprovua rendi ditës.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se para se me filluar me ngritjen e pyetjeve çështjeve, sot të gjithë e kemi nga një shallë dhe ë dekorimi i sallës që është bërë nga Këshilli Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore, I falënderoj të gjithë Këshillin, është njëri ndër këshillat më aktive dhe ndër ndër e para të themelum që po bëjnë një punë të jashtëzakonshme dhe që besoj që në mbledhjen e ardhshme do ta kemi edhe një plan strategjikë do t'ia prezantojmë Kuvendit. Unë gjithë juve ju bëj thirrje që t'i bashkëngjiteni kësaj fushate pesëmbëdhjetë ditore në ditët në vazhdim dhe uroj që kjo dukuri negative të jetë sa më e vogël në në Komunën tonë, edhe gjithë në gjithë vendin tonë.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Xhyla Dedushaj-Rexhepi, tha se i drejtohem drejtoreshës së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Me një kërkesë, në praktikat e viteve të kaluara, e dimë që komuna e Lipjanit ka përzgjedhur çdo ditë sportistin e vitit, një gjë e tillë tashmë tri vite nuk po aplikohet, sugjeroj që DKRS-ja- të nisë në procedurat e nevojshme dhe të rikthejë këtë traditë në komunën tonë qe sportisti i vitit 2023 të përzgjidhet në mënyrë që të motivohen dhe nderohen ata që korrin suksese gjatë një viti.

Albiona Tasholli, tha se këtë fjalim po e nis duke falënderuar Drejtorinë e Administratës, Zyrën për Barazi Gjinore që treguan vullnet dhe ishin gjithmonë të gatshëm për gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.

Vlen të theksohet se Këshilli Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore në Lipjan është formuar në vitin 2016 me vendim të kryetarit Imri Ahmeti, i cili sot si këshill po tregon rëndësinë dhe suksesin e vet në kuadër të kësaj teme. Gjithashtu këto ditë kam qenë në vizitë në QMF Gadime dhe në QMF Janjevë dhe me të vërtetë ato investime ishin investime shembull, të cilat dukshëm kanë përmirësuar dhe lehtësuar jetën e çdo qytetari. Rregullimi i QMF-ve ishte kërkesë e imja para disa seancave dhe këtu kërkesa tashmë të realizuara në mënyrën më të mirë. Gjithashtu kam një kërkesë për drejtorinë e shëndetësisë në qoftë se është e mundur që të krijohet mundësia e të vazhdohet marrëveshja me Drejtorinë e Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës që gratë nga komuna jonë t'i nënshtrohen ekzaminimit të mamografisë për diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit. Pastaj tha se kam disa kërkesa për drejtorinë e Infrastrukturës lidhur me përmirësimin e infrastrukturës rrugore, të cilat me ja adresuar nga disa banorë të Gadimes të, Resiovcit dhe Zllakuqanit. Në Gatimet e Ulët, konkretisht në rrugën te Tashollt, banorët e kësaj ane kërkojnë të bëhet ndriçimi, që është më se e nevojshme, pasi kjo rrugë është e frekuentueshme dhe ndriçimi do të rrisë sigurinë dhe përmirëson kushtet e qarkullimit. Gjithashtu, nga banorët e Resiovcit kanë marrë si kërkesë që të bëhet ndriçimi dhe ndërtimi i trotuarit, të cilin si kërkesë është e nevojshme gjithashtu për të përmirësuar infrastrukturën rrugore. Në lidhje me kërkesat e banorëve të Zakaqanit kanë kërkuar që të bëhet ndërtimi i trotuarit. Dekorimi i qytetit për festat e fund vitit, një ambient festiv, i sugjeroj kësaj drejtorie që të krijojë mundësia që të bëhet vendosja e shtëpizave të drurit në shesh, si dhe të bëhet organizimi i netëve festive të drejtorit si dhe të zhvillojnë aktivitete muzikore. Kërkesë tjetër, që të bëhet zgjedhja e sportistit të vitit, gjithashtu edhe këtu procedura propozoi që të bëhet edhe zgjedhja e lexuesit të vitit.

Ganimete Qeriqi, tha se Bora që ra këto dite rrugët automobilistike dhe trotualet të ndara si me thikë ,rrugët automobilistike të pastruara, a trotualet si me kanë vend që lëvizin robotët, është rrugë me e cenueshme e qytetareve siç janë: nënat me fëmijët e tyre në karrocë, personat me nevojë të veçantë dhe pëlqeve që shumica po jetojnë vetëm dhe ju është deshtë me dal me ble ushqime. Se me pas kanë qytetari i siguruar e këto pasoja me dëmtuar buxhetin e komunës ,parësore kish qen pastrimi i trotualetve. Ky veprim i shtetit ka qen diskriminues. Nje dukuri qe po dua me specifikuar para jush e qe është përgjegjësi e drejtorisë se inspektoratit, shoh ne mëngjes herët te dyert e lokaleve pjata, gota, filxhana etj ,që punëtorët kanë porositë ushqime ,kafe e çaja i kanë pirë dhe pjatat i kanë qit jashtë, me logjikën qe vjen kamerieri i merr .Ky veprim është tërësisht i gabuar. Ato pjata qe kanë qëndrua gjithë natën jashtë normal se pastrohen. Inspektorati duhet me rrit nivelin e vetëdijes, e mos

me u keqpërdor shërbimet e gastronomisë, me rrit nivelin e vetëdijesimit të punëtorëve, mu rrit niveli i higjienës, më obliguar bizneset me organizuar trajnime profesionale në gastronomi e të tjera..

Lumturije Bytyi-Hasani, tha se unë kam të njëjtën vërejtje për pastrimin e borës për drejtorinë përkatëse, nuk janë pastrua trotualet në kohë e aq më keq nuk është pastrua sheshi për tri ditë të radhës dhe pas reshjeve të mëdha të borës që patëm këtë vit. Kërkoj nga drejtoria përkatëse që të jetë më vigjilente dhe kompanisë t'ia bëjë këtë vërejtje që trotualet, të paktën afër sheshit, të jenë të pastruara, sepse qytetarët po kanë të pamundur me kalua nëpër trotuare dhe duhet me e shfrytëzua rrugën për etje. Çështja në fund të mandatit të kaluar, në mes të kuvendit kemi iniciuar procedurat për themelimin e ndërmarrjes publike Ulpiana. E di që është çështja e qeverisë e cila do ta marrë vendimin e parë dhe kjo do zgjatë të paktën një vit, u bënë më shumë që dy vite dhe nuk kemi parë ndonjë hap në lidhje me themelimin e kësaj ndërmarrje, që parashihet e ishte shumë produktive për qytetarët, e sidomos për Komunën. Do të doja me ditë sesa janë ndjek procedurat, a mundësi që kjo ndërmarrje të realizohet.

Arsim Jashari, tha se në emër të Grupit të Asamblesë së PDK- se mbështesim fushatën ndaj në përgjithësi, shpresojmë një vetëdijesim të shoqërisë e mos të ndodhim më rastet që po ndodhin. Kam disa kërkesa të banorëve dhe disa pyetje për ekzekutivin, përkatësisht për drejtorinë përkatëse. Kërkesa e parë vjen nga banorët që banojnë pjesën tjetër nga rruga, domethënë ku në mungesë të një mbikalimi po kanë probleme shumë për të kaluar binarët e trenit, sidomos kur ka reshja borës së madhe. Kërkesa e dytë, një nga disa qytetarë, të cilët janë të zhgënjyer, lidhen me konkurset e dhe punësimet e njëanshme mbi baza partiake që ndodhin nga ekzekutivi me emër të njerëzve të LDK-së, rekrutimi dhe përzgjedhja do të jenë të bazuar në një proces transparent të paanshëm që nënshtron konkurrencën pa marrë parasysh bindjet politike, unë mendoj që u bë e tepërt. Tjetra vendosja e flamujve jo në rregull për festën e nëntorit e di që nuk është faji juaj, por është i kompanisë por duhet me marrë një dikush përgjegjësi, duhet me pas kujdes, se flamujt kombëtarë, flamujt shtetërorë, si po vendosen. Po flitet përsëri kryetar se ka një marrëveshje lidhur me deponinë regjionale që të dislokohe në komunën tonë. A është e vërtetë dhe nëse është e vërtetë, cila është arsyeja e pranimi të kësaj marrëveshje? Pyetje për drejtorin e Infrastrukturës cili është problemi, me kualitetin e dobët të punëve, të cilat po kryejnë infrastrukturë, dhe duke filluar nga asfaltimet, nderimi i shkollave trotualet. Po më intereson me ditë ku qëndron problemi, që është kualiteti i punëve kaq i dobët, është mirë me marrë masa. Pyetjen e katërt e kam për drejtorin e Shëndetësisë. Si ka mundësi të anulohet testi me shkrim për infermierë, kur dihet që në publik kanë dalë pyetjeve, të cilat janë

përgatitur nga komisioni E ndërsa anulohet kinse për është gabim teknik, kur kryetarja e komisionit e pranon publikisht që kanë rrjedh pyetjet. Kjo është bërë tash me standarde në anulimi i konkurseve për gabime teknike dhe nga kjo foltore ju bëj thirrje organeve të drejtësisë që të merren me këto raste.

Lulzim Rrustemi, tha se më lejoni që, meqenëse hala kemi frymën e festave të nëntorit, që uroj festat e muajit të nëntorit, është nder dhe privilegj ti festojmë festat në mënyrë të dinjitetshme. Kam disa pyetje për kryetarin edhe Drejtorin e Arsimit për bursat. Ju kam parë që kanë dalë publikimet edhe të listës finale, edhe të listës preliminare. Në listën preliminare kanë qenë 170 bursa të ndarë në listën finale, 172, kam pyetje a ka pasur kërkesa për bursa të studentëve që studiojnë jashtë Kosovës dhe çka është bërë me bursat me 9 kandidatët, të vitit të kaluar, që nuk kanë marrë bursa e kanë studiuar jashtë vendit. E dyta, kam një kërkesë për fshatin Brus është një ankesë jashtëzakonisht e madhe e fshatit Brus për pusët e ujit të pijshëm atje janë hap disa puse dhe kam kërkesë që dhe gjithashtu reagim se gjatë hapjes së puseve po ndahet edhe në shtëpitë që s'ka banorë unë kam propozim që kjo zgjidhje dhe bëhet edhe përmes tejkallimit të buxhetit në vitin e ardhshëm, propozohet një ujësjellës lokal, meqenëse ata janë jashtë rrjetit të ujësjellësve të Lipjanit, ka mundësi një ujësjellës lokal në Brus me gjetë burimin dhe me i furnizua të gjithë ata qytetarë me ujësjellës të rregullt, e cili besoj që kostoja e tij nuk do të jetë e madhe. Kam një shkresë, gjegjësisht një ankesë për ish-punëtorët e administratës komunale dhe ish-veprimtarët që kanë punuar në Komunën e Lipjanit ne jemi dëshmitarë që edhe për të ndjeren ish-profesoreshën Hajrie, po edhe tash për të ndjeren Sami Murati të cilët kanë qenë punëtorë me vite të gjata në shërbimin profesional Samiu, në Kuvendin e Lipjanit për shumë vite dhe ia jep deputetëve katër mandat të legjislacionit ekzekutivi, kurse komuna nuk ngjan kohë për me bo akademi përkujtimore s'duhet me bë përjashtime dhe është shumë fisnike me përkujtuar njerëzit që japin kontributin. Tjetra ju nuk i keni marrë votat për me i shkelë ligjet. Ju i keni votat për m'i menaxhua, për me udhëheqë me komunën, por jo me i shkelë ligjet, dalin testet, publikohen testet në QKMK, i ipën 10 vota, dhjetë pikë më shumë kandidatët që nuk ka më njerëz se një mjeku tjetër. Unë besoj që qytetarët s'kanë me toleruar këto, po është mirë administratën me pas kujdesin dhe qeverisja.

Egzona Bytyqi, tha se kam se si mos me e nis sot këtë seancë meqenëse jemi në gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit të secilës formë të dhunës në bazë gjinore edhe shfrytëzoj rastin që të bëjë thirrje sensibilizuese nga kjo foltore për gjithë shoqërinë tonë që për çdo ditë, jo vetëm në këtë muaj edhe në muajin e ardhshëm dhjetor, mirëpo në përgjithësi. Çështja tjetër ka të bëjë me Drejtorinë e Shëndetësisë, e kemi përmendë

jashtëzakonisht shumë kujdesin paliativ, i cili realisht me ju thanë të drejtën për nga natyra se si funksionon tani, me të drejtë e kisha emërua vizitat shtëpiake që ofrojnë shërbime shëndetësore, mirëpo përveç asaj, ne po shohim që opinioni jonë është sensibilizu dhe ka njohuri tashmë Më tepër që ky shërbim ekziston në komunën tonë, kërkesat janë shumë të mëdhaja dhe lus drejtorinë që në koordinim me qendrën kryesore të mjekësisë familjare do të bëjmë përpjekje që me mujt me kriju edhe një një ekip, ekipin e dytë, domethënë ndërrimin e dytë që ky shërbim me me qenë funksional. Përveç rëndësisë primare domethënë edhe një ekip i tillë kish me liru jashtëzakonisht shumë emergjencën, sepse gjithë ne që kemi punuar këtu dhe kemi qenë pjesë e saj, dihet që një numër i madh i pacientave që ofrojnë shërbime shëndetësore në mesnatë në emergjencë domethënë janë raste janë raste paliative. Edhe kur jemi te kryer shërbim, kisha dashtë me e pyet kryetarin, meqenëse ka qenë premtim nga ky kuvend, kur ka marrë ajo vetura. Çështje tjetër ka të bëjë me qetë endacak, përderisa ne kemi mungesë të një strategjie të karakterit nacional, në anën tjetër po ballafaqohemi me në suaza ditore me këtë problematikë. Unë kam marrë disa ankesa nga prindërit që detyrohen me i dërguar fëmijët e tyre në shkollën fillore “Vëllezërit të Frashëri”, domethënë për shkak që aty afër jo jo shumë larg metra, gjenden kontinierat domethënë ata më kanë kërkuar dhe është propozim i jemi qënë bashkëpunim me Kompaninë e Pastrimit me u mundu që ose me vendos kapak se tash jemi në zonën e Dimrit, dihen që këto shtazë mund me qenë edhe acaruese dhe po e rrezikojnë fëmijët dhe qytetarët në përgjithësi. Ura e cila gjendet që të thoni ku që është e demoluar në fshatin Rrufës të Ri dhe Hallaq të Vogël ka qenë edhe kërkesë mediale më intereson me dijë deri vonë ka qenë në kuadër të projektit qeveritar dua të di ku ka mbërri këtij projekt.

Alban Salihu, tha se kryesues mendoj që bëre shkelje të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe të Rregullores së Kuvendit kur nuk e vendosën në votim pikën që e propozova, për shkak se ju e udhëhiqni punën e Kuvendit dhe ju duhet ta merrni parasysh propozimet e anëtareve te kuvendnit dhe Përgjigja e kryetarit nuk ka të bëjë me çka unë e kërkoja. Kërkesa jonë po të bëjë në vitin 2023, nëse të ishin ngarkesat tatimore edhe në dokumentin që iu referuar Kryetari, fshihet që aty ngarkesa tatimore për vitin 2023 ndërsa 2024 është 150 mijë euro Kështu që nuk e kuptoj hezitimin për me vendos në votë, e pastaj në votë nëse mendoni që nuk ia vlen të kalohet të rrëzohet. Tjetra para vetes e kam një petition, i cili është dorëzuar nga disa fshatarë të fshatit Llugaxhi në vitin 2020, ka të bëjë me një petition për rregullimin e një kanalizimi që po ju shkakton dëme që një kohë të gjatë. Sipas banorëve të cilët më kanë marrë me i taku, ankesa e tyre është që nuk kanë marrë përgjigje dhe nuk po marrën askush me këtë çështje, është e papërgjegjshme që një temë kaq të ndjeshme mos me e trajtua dhe

mos me e dhënë mundësinë për me për me i ofruar zgjidhje. Çështja tjetër që nuk do të mund të kalojë pa e ngritur këtu, edhe pse ka të bëjë me konkursin nga Drejtoria e Shëndetësisë me vjedhjen e pyetjeve me skandalin që ka dalë edhe në media, mendoj që është e papërgjegjshme dhe e papranueshme një gjë e tillë, vazhdimisht, konkurset publike në Komunën e Lipjanit manipulohen. Çka e bën edhe ma skandaloze krejt këtë krejt ngjarje është edhe fakti që në konkursin që ka dalë para dy dite pothuajse Po ju dërgoni mesazh qytetarëve që na nuk e çajmë kokën, pavarësisht pse ka dalë kjo skandal dhe jemi në zonë flagrant, ne i shtyjme përpara edhe nuk na intereson opinionin ose çka flitet. Unë nga këto i bëjë thirrje edhe Komisionit që ka qenë në këtë mjekëve, ose kush ka qenë pjesë e këtij komisioni, që ta vendosin dinjitetin njerëzor dhe profesional dhe mos t'ju hijnë në hakë kandidatëve për shkak se njëmijë njëqind kandidatë janë mal tretuar duke ardhë në këtë konkurs, për të cilët vetëm sa pranimi ka ndodhë më herët.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, se e përgëzoj Zyrën e Barazinë Gjinore për shënimin e gjashtëmbëdhjetë ditëshit të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas. Besoj që edhe zyra, edhe sektorët tjerë do të jenë të përkushtuara këto ditë që të shënohet, siç edhe po duket sot, një punë e mirë. Disa prej temave që u ngritën janë vërtet të që mund t'i kontribuojnë përmirësimit të performancës të ekzekutivit, në fakt mund t'i kontribuojnë përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve. Ne kemi pasë një mamografi donacion, të cilat, për shkak të specifikat të saj nuk kanë mujt asnjëherë me i gjetë pjesët rezervë. Në këtë javë, nëse merr koha mirë ose javën e ardhshme, po besoj, do të fillon edhe Qendra e Emergjencës dhe Urgjencës dhe do të hiqen ato baraka të trashëguara prej kohës së kaluar, kontratë është nënshkruar. Në fakt kërkesa për rrugica, për trotuare, për ndriçime publike, natyrisht që ka nevojë akoma në terrenin tonë, ka nevojë për edhe për ndriçim edhe për trotuare, për keni parasysh që projeksionet buxhetore ku të bëhen të bëhen këto kërkesa jo zakonisht do seancë ngritën tema të tilla, kur fare s'e kemi në trajtim buxhetin. Unë e kam thënë dhe vazhdoj të them para publikut pa hezitim dhe pa me marrë parasysh koston politike nuk e kemi luksin në çdo rrugicë të çdo familje për të pasë ndriçim. Sa i përket rrugëve sekondare i kemi vetëm dy fshatra që nuk i kane rrugët e shtruar, natyrisht që ka nevojë trotuare dhe jo veç Zllakuqan, ne jemi atje të ndërtua rrugën, kemi probleme pronësore. Sa i përket ndërmarrjes në kemi qenë në komisionin ndërministror, me dy drejtorë dhe personalisht, për të arsyetua themelimin e kësaj ndërmarrje, si duket nuk ka vullnet sepse themelimi i kësaj ndërmarrje do të eliminonte mundësinë e kontraktimit të punëve për shërbime të caktuara. Një pyetje më rëndësi për nënkalimin ose në kalim të hekurudhë. Por qeveria ka të drejtë me shpronësua prona, sepse vendimmarrja e qeverisë është vendimmarrja e qeverisë, nuk kam asnjë dëgjim

publik këtu në sallë me organizuar ministria, e kam refuzuar lidhur me këtë temë, nuk e kemi nda para as ministria as na këtu. Sa i përket deponisë, do të lejoj, nëse natyrisht na dhënë mbështetjen ligjore, ose na jep të drejtën ligji me refuzuar, në të kundërtën ta shohim si për rrjedhë neve t'ia heq më larg, na ka ardh një material në të cilin na bënë media për pronat që ata i kanë shpronësuar, për të bërë një deponi. Prandaj, ne do të ta kundërshtojmë këtë deponi. As na ka ndihmuar në asnjë rrugë, as na kanë ndihmuar në ndërmarrjen komunale, as mos të përmendur asnjë cent e keni projektin buxhetor për vitin e ardhshëm. Pusët e ujit po ne fakt ne nuk e zgjidhnim përfituesit e puseve, na prapë e kemi një kërkesë tek organizata të mos përmendën e saj me vazhduar me hapjen e këtyre puseve. Veturat janë me rentë me qira, qeveria i ka pas marrë, qeveria na i ka dhënë në atë kohë dhe në afat, këto duhet me u kthyer, duhet me u kthyer të janë të kontraktume. Na i kemi shpall veturat ne tender të Prokurimit Publik një herë, pra në vitin e kaluar por nuk na kanë lejuar, i kemi shpall prap tani. Po ajo që po e ndarë me juve si shqetësim kena me pas problem me mbuluar terrenin pa kerre. Sa i përket konkursit po të ishin shkuar pyetjet aty, ata i kishim zgjedhë. Prandaj, , s'duhet me jep kahje politike dhe nuk duhet me e nda sepse s'pajtohna me ty. Për mu të gjithë qytetarët janë barabartë edhe po provojmë me punuar për gjithë me njëjte.

Alban Salihu, tha se testi ka rrjedhë një ditë përpara, ajo në ditën e mbajtjes të testit, domethënë me thanë e pamundur që gjatë testit me ua dërguar dikush nga i një grup ku ka kërkuar me i ndihmuar me marrë përgjigje. Tjetra çka po dua me thanë, e kam thënë edhe një herë në Kuvend, që nëse e dëgjo ligjërimin e Kryetarit këtu, të krijohet përshtypja që jemi në Kuvendin e Kosovës, për shkak që ky vazhdimisht merret veç me Qeverinë e Kosovës e jo me çështjet për të cilat ne po diskutojmë këtu. Kisha ftuar që kur jemi në Kuvend, flisni për punë të Komunës e jo për qeveri.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se që tri vjet e kemi kërkesën për ndërmarrjen komunale, dhe nuk kemi marr përgjigje. Një kanalizim e kemi pas me projekt tjetër. Unë në politikë jam moti dhe ne kemi pas projekte nga qeveria edhe kur ka qen PDK-ja në pushtet, edhe Aleanca në pushtet, i kanë ndihmuar Lipjanit, ndërsa ju nuk i keni nihtuar vetëm e keni penguar. Duhet me u bërë pak ma lokalista e jo me pengu me çdo kusht pse është i partisë tjetër.

Alban Salihu, tha se ka dallim shumë, më ka pengu edhe s'më ka ndihmuar. Është një dallim i madh, se krejt po thotë ma kanë pengu, se nuk ju ka pengu, nuk është e vërtetëve që s'ka investime në Komunën e Lipjanit, na krenohemi sot me një stadium në Lipjan Sami Kelmendi që është në qytet, ai është bashkëfinancim me qeverinë. E kemi përrurua një sallë sportive që është bashkëfinancim me mjetet e

qeverisë në rrugën Ura, këtu që dërgon në rrugën në fshatin Rufe ju kanë ofruar mjeteve, nuk keni kanë të gatshëm me participu që me i shtua një pjesë edhe për me rregullua e me zgjidh një çështje kaq të mundësish më vonon. Domethënë, nuk janë të vërteta këto që po që po i thoni, por është njëfarë tendencës me shpërnda mjgull.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se Stadiumi “Sami Kelemndi”, kush e mbandi në mend është në kohën e Kujtim Shales po ashtu edhe Fusha sportive është në kohën e Kujtim Shalës. Ndërsa kjo qeveri nuk e ka financuar asnjë projekt në Lipjan. Mos provojeni me na pengu, se skeni me muajt me na penguar.

Arsim Jashari, tha se kryetar në at moment që do qeveria me prurje deponinë ilegale, na ki edhe grupin e asamblesë të PDK-së mbrapa me të gjithë qytetarët, se po mendoj që Lipjani nuk ka nevojë për mbeturina. Lipjani është qytet i mirë dhe a po bindni që inatet politike dhe vullneti politik kanë një diferencë shumë të madhe edhe kjo është t'u i kushtuar shoqërisë tonë.

Shahadije Bikliqi, tha se këtu në këtë sallë me të vërtetë nuk ka kushte edhe është tepër ftohtë dhe ky problem po vazhdon që një vit Çështja e parë, apo ankesa e parë të cilëndo ka të bëjë me banorët e Janjevës, të cilët po kërkojnë që të ndërtohet një trotuar në atë pjesën në hyrje të Janjevës, konkretisht nga restorant Ania, mungesa e një trotuari po rrezikon ata banorë të cilët qarkullojnë shkak të edhe të qarkullimit të madh dhe të shpejt Çështja tjetër ka të bëjë sërish me Janjevën, është çështja e mungesës së transportit apo në mungesa e transportit. Duhet të ju behet një zgjidhje këtyre banorëve. Tjetra shqetësimi apo reagimi im tjetër është se ku Lipjan kanë nisur punimet për ndërtimin e vazhdimet të sheshit, parkingut nëntokësor e parkut apo më mirë me thënë ka hapur një gropë të vogël dhe një gropë të madhe diku duke bllokuar kështu rrugën kryesore katër kursi për qarkullim dhe ka shkaktuar një situatë mjaft kaotike e sidomos i ka shqetësuar banorët të cilët edhe i ka i rrethuar me mos punën apo punën e paktë që është duke u bërë. Çka do të ndodhë kur do kjo të më vijë mërgimtarët mendoj se do të shkojë drejt bllokimit, kur tash ku pritët që ardhja e mërgimtarëve do të jetë këtë vit numri më i madh dhe me të vërtetë mendoj që Lipjani do të bllokohet nga trafiku dhe do të shkaktohet një kaos i madh.

Herolind Kozhani, tha se dje ishim në vizitë në çerdhen e Shalë, ishim së bashku me kolegët e Komitetit për Arsim ku patëm një mikpritje mjaft të mirë nga stafi i çerdhes, ndërsa në vizitën e dytë, të cilën e kishim planifikuar në shkollën 7 Marsi në Poturovc edhe pse kishim caktuar takim, nuk po mirëpritëm fare nga drejtori i shkollës, po ashtu kushtet e punës nuk ishin aspak të mira për t'u zhvilluar. Për shkak të i ftohtë që po mbretëronte brenda ambientit shkollor aneksi prej klasës gjashtë deri

të nëntën, e lus drejtorit të arsimit të marrë masa tejet një ambient sa më i ngrohtë për nxënësit dhe kolektivin e shkollës. Çështja e dytë është se pas të reshurave të fundit kanë parë një shqetësim të qarkullimit të ujit mbi rrugë, si pasojë e mbylljes së kanaleve atmosferike. Çështje tjetër është e ditëve të fundit është duke bërë hapja dhe rregullimi i rrugës Bashkim Krasniqi në Lipjan, që lidh me dy rrugë të tjera një projekt mirë i qëlluar, por fatkeqësisht punët po vijnë shumë ngadalë, kjo gjë ka shkaktuar edhe një shqetësim të qytetarët që jetojnë në atë pjesë. Kisha kërkuar nga drejtoria për ka se sa dimë se po ndodh një gjë e tillë, kur është bërë planifikime që kjo rrugë të jetë në funksion.

Besiana Syla, tha se në këtë seancë dua ta ngris një çështje dhunën ndaj grave kjo temë mjaft e ndjeshme, sikurse në shumë zona tjera të shtetit, është alarmante dhe shqetësuese edhe në komunën e Lipjanit. Vetëm këtë vit thuhet se janë regjistruar 56 raste të dhunës në familje, ku cak kanë qenë vajzat dhe gratë, si dhe afro 70 raste numërohen për çdo vit në vitet paraprak. Shqetësuese, mbetet edhe më serioziteti i institucioneve tona komunale për ta trajtuar këtë temë dhe për t'u përballur me dhunën që shkaktojnë ndaj grave dhe elementet që çojnë deri tek dhuna. Komuna e Lipjanit nuk e ka trajtuar këtë temë brenda buxhetit dhe nuk ka pasur as hapa konkret që të sigurojë strehim për viktimat që janë ose potencialisht mund të jenë pjesë e dhunës në familje. Nga ana ime po i cek disa pika që do duhej të merresh në konsideratë nga organet komunale të Lipjanit ku bëjnë pjesë: analiza në aspektin ligjor dhe analiza dhe si buron e nga krijohet dhuna ndaj grave e gjithashtu si duhet të luftohet dhuna; fushata vetëdijësuese për qytetarët; formimi i një fondi emergjent për t'i mbështetur gratë që ballafaqohen me dhunë në familje apo jashtë familjes të bëhet subvencionim i qirasë për viktimat që kanë qenë apo mund të jenë cak i dhunës. Të krijohet bashkëpunim me institucioneve dhe bizneseve të ndryshme, në mënyrë që të ketë mundësi punësimi për vajza dhe gratë, rrjedhimisht kjo ua hap një derë që të mos i ekspozohen rreziqeve të dhunës shkaku i faktorit financiar. Një çështje tjetër, e cila ka të bëjë me fshatin Sllavi, konkretisht domethënë në lagjen Lagjja e Re ata qytetarë të atij fshati kanë mungesë të asfaltimit rrugës diku rreth 13 familje. Rruga është publike dhe kërkoj nga ana e ekzekutivit të ndanë mjete financiare për atë rrugë që të asfaltohet.

Fadil Spahiu, tha se kam për të ngritur dy kërkesa dhe një pyetje për ekzekutimin e kështu e parë është për Drejtorinë e Infrastrukturës. Familja Idriz dhe Fatmir Sopa kanë bërë kërkesë që në kuadër të projektit të asfaltimit të rrugicave të hapet dhe të ndërtohet dhe në bazë të mundësive të asfaltohet rrugica e Lagjes së tyre, e cila lidhet me rrugën 11 qershorit me në fshatin Smallushë Fëmijët e këtyre familjeve

në pamundësi për të kaluar nëpër këtë rrugë duhet të kalojnë nëpër rrugë alternative me gjatësi prej 1.5 klm. është pronë publike dhe e kategorizuar si rrugë. Kërkesa e dytë është përsëri për Drejtorinë e Infrastrukturës banorët e një lagje, që lidhet me rrugën Bujaria. Në fshatin Bujari, kanë bërë kërkesë që në kuadër të projektit të asfaltimit të rrugicave të asfaltohet rrugica e lagjes së tyre. Krijimi i kësaj rrugice është bërë nga familja Nuhi, Emini, Emini dhe Maksud Jakupi, të cilët nga parcelat e tyre i kanë ndarë nga dy metra gjerësi dhe 250metra cilën e kanë shtruar me zhavorr, e që tash në total janë tetë familje që e shfrytëzojnë këtë rrugicë. Te kjo rrugice janë prona private, por ushtruesit e kërkesës kanë shprehur gatishmëri për marrëveshje për asfaltim apo edhe t'i kalojnë në prona publike nëse është e nevojshme. Edhe pyetje për ekzekutivin përsëri. Siç edhe e kam theksuar në fillim të punimeve të ndërtimit të shtratis të lumit se projekti është shumë i mirë dhe se punët janë duke u vazhduar shumë mirë. Por kam një pyetje për ekzekutivin. Urat e rrugëve publike të cilat kalojnë nëpër atë lum për nga lartësia janë më të ulëta se shtrati i lumit. Pra, në kuadër të projektit të ndërtimit të ujërave në fshat në fshatra do të bëhet ngritja e lartësisë së urave, sepse nëse mbesin ashtu siç janë domethënë do të jenë se më të ulëta se shtrati i lumit dhe uji do të ketë mundësi që të futen nga borxhet dhe shtëpitë e fshatit.

Ardit Cani, tha se çështja e parë për të cilën kam reaguar vetë personalisht, ka të bëjë me QMF-në në Shalë, ku po vërej një mosrespektim të orarit të punës nga doktorët. Personalisht kam qenë dy herë ku ka pasur mungesa dhe është lëshuar orari i punës sidomos pasdite I bëj thirrje drejtorisë së shëndetësisë që të merr masa në këtë aspekt, sepse në këtë në QMF shërbehemi shumë banorë, si të shalës, Baincës dhe Risinovit Shalës Kërkesë tjetër ka të bëjnë, e kam ngritur edhe më herët që afro dy vite, mirëpo ende nuk është marrë marrë sa nga drejtoria e Shërbimeve Publike ka të bëjë me pastrimin e lumit Drenica, pasi që e dimë që është e nënshkruar kontrata për hapjen e lumenjve , mirëpo nuk është marrë masa se dhe pasi që jemi në kohën e dimrit, vetëm që lumi Drenica ka filluar të rritet uji tij. Kjo pjesë ka mbetur të hapet vetëm nga Bainca deri në pjesën që lihet me Nekovc Kërkese e banorëve të fshatit Risinovc qe të hapin kanalizimin në mënyrën qe kanalizimi ka mbet e gjysmë dhe kjo është prapë këtë vështirësia për banuarit e fshatit Kërkesa tjetër është për asfaltimin e një rruge në fshatin Mirenë, te rrugës Troja qe është shumë e nevojshme.

Dimanat Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se, kisha dashtë me falënderua Këshillin Koordinues për Mbrojtje të Viktimave të Dhunës në Baza Gjimore dhe Zyrën për Barazi Gjimore në Komunën e Lipjanit për aktivitetin e sotëm dhe për një mesazh shumë të rëndësishëm që e kanë dhanë me këtë aktivizim. Në pjesën e poshtme, ku vërtet ë çdo ditë po zgjerohet Janjeva, është i nevojshëm trotuari, për shkak se edhe

ndriçimi ka përfunduar në atë pjesë edhe sigurisht që në të ardhmen do të rregullohet edhe trotuari. Për çështjen e transportit Personalisht edhe unë jam angazhuar që të sigurojmë transport për Janjevancit, për linjën Janjevë-Prishtinë që ka ekzistuar më herët, por edhe për shkak të mungesës së udhëtarëve është ndërprerë. Kjo është çështje, por sigurisht edhe kryetari është angazhuar direkt me Komunën e Prishtinës që kontaktojmë prapë që kjo linjë të aktivizohet të paktën tri herë, por nuk kemi operatorë të interesuar që kjo linjë të aktivizohet. Një segment i plotë i kanalizimit ë ka pasur nevojë që të që të kyçet dhe do të vazhdojmë punimet për integrimin e sheshit dhe punimet në nënkalimin dhe sigurisht që Do të ketë vështirësi me transportin në qytet në disa pjesë, mirëpo deri më tani ka funksionuar mjaft mirë dhe besomë që edhe shumë shpejt të funksionojë kështu edhe derisa të përfundojë të paktën nënkalimi dhe të hapet rruga kryesore. Faqe e komunës kanë në problem ne te gjithë Kosovën dhe sigurisht që kontrata e mirëmbajtjes së këtyre skaduar dhe është në proces të lidhjes së një kontrate të re dhe kjo i ka thënë përgjegjësitë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Rruga Bashkim-Krasniqi është një projekt dyvjeçar, këtë vit do të bëhet vetëm zhavorrimi i rrugës. Vitin e ardhshëm do të përfundojë asfaltimi. Kuvendi kemi mbështetur organizatën që bën strehimin e e grave; është me ndërmjetimin e OSBE-së dhe komunitat e regjionit kanë një bashkëpunim ku financohen dhe sigurisht këto raste mbesin konfidenciale dhe nuk publikohen Domethënë, vazhdimisht qendra për punë sociale i trajton edhe gratë që kanë probleme në familje dhe përjetojnë rrugë në familje dhe trajtohen dinjitetshëm dhe me një konfidencialitet të plotë. Domethënë, trajtohen Asfaltimi i rrugicave në Sllovi ka filluar prej fillimit të fshatit dhe çdo rrugë që është në Sllovi do të asfaltohet. Rrugica me fjalë sigurisht që do të vazhdojë në fazën në fazën e ardhshme, tashmë është në përfundim edhe shtrati i lumit. Shtrati i lumit është është ngritur me qëllim më më lart se sa niveli që ka qenë, por nuk kjo nuk do të thotë që niveli i ujit do të shkojë derisa është se është edhe ndërtimi i urës, mirëpo është ndërtuar edhe për me rritë kujdesin Edhe ujërat që janë aktuale janë funksionale dhe niveli i ujit nuk mbërrinë deri te ujërat aktuale. Domethënë nuk ka nevojë për ndërtim të ujërave të reja me lartësi që janë ndërtuar sa shtrati i lumit. Po ashtu edhe në Bujari vitin e ardhshëm do të ketë asfaltime edhe në Bujari edhe në Lugaxhi. Hapja e lumi Drenica, vërtet nëse është kërkesë shumë e nevojshme, ne e kemi një kontratë tashmë të nënshkruar. Pre asfaltimi i rrugës Troja në Mirenë në vitin e ardhshëm është në projekt.

Besiana Sylja, tha se në bazë të raporteve financiare, unë e kam pa që Komuna e Lipjanit nuk ka nda buxhet konkretisht për dhunën ndaj grave, domethënë për as për vitin 2023, as për vitin 2024 Buxhet nuk kam pa që ka nda edhe unë jua bëj një

pyetje: Kur ka plane konkrete dhe kur planifikohet m'u nda buxhet edhe kështu publikisht domethënë edhe me realizua premtimin?

Daut Azemi, kryesues i kuvendnit tha se ka buxhet të vazhdueshëm edhe ë vazhdimisht ka buxhet të vazhdimisht të mbështetur. Është një këshill komunal i cili e ka bërë punën sot bashkë me zyrën për barazi gjinore, që është ndër këshillat e para në nivel të Kosovës që është i themeluar dhe që vazhdimisht bënë punë, e thashë edhe në fillim, e këta këshill mbështet nga zyra e kryetarëve dhe është buxheti që dedikohet. Janë ndarë raste që janë raste të dhunës, janë specifika të ndishme dhe janë të konfidenciale, të cilat i trajton këtë cilin rast ves vese cila për punë sociale qysh e tha nënkryetari.

Diamant Bytyqi, tha se është një çështje shumë e rëndësishme dhe duhet ë vërtet një sensibilizim gjithë shoqërinë Pikërisht prej këtij Kuvendi, edhe ju keni votuar të gjithë, ppozita edhe opozita, kemi tashmë herët e kemi një bashkëpunim regional me ndërmjetësimin e OSBE-së ë për mbështetjen dhe subvencionimin e Qendrës Strehimore në Prishtinë, kemi ndarë një shumë të caktuar proporcionale me të gjitha komunat e regjionit për ta subvencionuar këtë qendër dhe prej këtij Kuvendit.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 23-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 23 e Kuvendit , pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 25 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 22-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se mos harroni ju, interpretimi i Gjykatës Kushtetuese flet për vitin 2023 unë jam unë jam delegat i Asociacionit të Komunave edhe besoj që këtë vendim ka me marrë Asociacioni i Komunave për falje, por duhet mi ndo dy gjëra. Ju kishit një lojë shumë mirë, është lojë, ku deri sivjet tatimi i tokave bujqësore nuk u paguar, andaj po na lironi në 2024 ne zëvendësoni domethënë mos mi prishë linjat buxhetore tuaj. Vendim i Gjykatës Kushtetuese ka pak do diskriminime brena për brena, pse, nëse unë e kam tatim 20 euro, e Luli ka tatim 100 euro, nuk barazohemi na si qytetarë aty është një diskriminim brenda përmenda se këtij vendimi. Problemi është diku tjetër, nëse vijë epet vendimi, a doni me prirjen e drejtuesit vendim? E kam një pyetje për juve drejtor, që atë thotë me rendin e tridhjetë ditësh e keni të drejtën ju këtu me votuar e mos me votuar, por me rendin e tridhjetë ditësh duhet me ardhë në Kuvend. Nëse vjen vendimi në Kuvend, po duhet Pra, posa një ndihmë si Grupi Parlamentar i PDK-së bëhen për shtesë, ne do votojmë.

Latif Ramadani, tha se neve nga ka ardhë një vendim të gjykatës, por është obligative që gjykatat të njoftojnë komunat. Mirëpo, në çdo vendim të Gjykatës Kushtetuese normalisht që respektojmë është e padrejta është çështje dhe interpretimi i joni që ka qenë që nënë momentin kur kemi vendosë këtë program, jo veç iluzionit këtë asociacion, kemi menduar që e ka tregu edhe e ka cenua integritetin e komunave. Po kemi caktua normën minimale për mos me ngarkuar qytetarët, normalisht që e kemi caktuar normën minimale tatimit të pronë, besoj shumë shpejt si asociacion, edhe si komune, edhe do të dalim në një qëndrim.

Pastaj u kalua ne piken ne vijim.

III

Diskutimi i raportit të planit të integritetit të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-LLugiqi, nga DKRS-ja, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë e kam lexuar me vëmendje këtë raport dhe e kam parë që aty janë ceket disa çështje që me të vërtetë nuk janë ashtu, njëra ndër të është respektimi i orarit të punës, kur dihet që disa nga zyrtaret e komune snuk e repketojnë orarin e punës ndodh që brenda orarit të punës dalin kryhen edhe detyrat e tyre private duke i quar edhe familjet në çerdhe. Dhe nuk duhet të cekëte që jen në rregull kur dihet që shumica nuk jen në rregull.

Egzona Bytyqi, tha se unë e kam lexuar me vëmendje dhe nuk kam çka më të shtunë me atë që e tha shefi i grupit tonë, mirëpo isha ndalë pak të metodologjia e frymës. Ky dokument është natyrës edhe orientues dhe strategjik që është në koordinim me legjislacionin e fuqi, me strategjinë shtetërore kundër korrupsionit që në parim domethënë ka bërë me llogaridhënie me transparencën drejtuar kah qytetari në mënyrë që mirëqenia e tyre me qenë e përmirësuar. Në momentin që janë identifikua 101 faktorë të rrezikut janë përshkruar edhe masat. Kjo është ndarje punëtorëve të drejtorive përkatëse, mirëpo për mendimin tim kishte me qenë në qoftë se e kishim ndërrua metodologjinë, e diskutim edhe mbledhjen në Komitet për Politikë dhe Financa. Kemi një gjithë përfshirje, përfshihen edhe rrjetet sociale, përfshihet edhe shoqëria civile, në mënyrë që na del një raport për integrim rreth më i detajuar dhe më kuptim qoftë.

Alban Salihu, tha se a i kemi plotësuar vetë këto të dhëna po i keni marr nga drejtoritë përkatëse këto të dhëna.

Anila Reqica-LLugiqi, tha se në këtë raport ka punuar një ekipë dhe ka pas dhe një koordinatorë ku i ka marr të dhënat nga drejtori të ndryshme dhe i kanë futur në këtë raport.

Arsim Jashari, tha se ky është një plan i drejt komunës dhe i drejt shoqërisë së komunës të Lipjanit dhe jo si grup asamblesë së PDK –së e mbështesim këtë plan.

Alban Salihu, tha se kini parasysh baza ligjore ose dokumentet që vijnë nga ministritë, këto janë normal, duhet me qenë të ngjashme për të gjitha komunat, vetëm statistikën, çështje tjera, ndryshojnë.

Anila Reqica-Llugiqi, tha se dua me falënderua edhe zyrtaren Linda Shahinin, që po e kisha atje, që vazhdimisht është marrë me këtë çështje dhe të marrë parasysh që kam qenë pjesë e ekipës kanë ardhë edhe një herë kërkesat nga Linda dhe edhe akterë të tjerë që kanë qenë të ekipës të saj, na mos t'i përmendet gjithë me emra, po e

kanë ba një punë të jashtëzakonshme për me qenë një raport real ashtu siç e kanë paraqitë.

Meqë diskutime tjera nuk pati u dha pauza nga ora 12:00 deri në 13:30

Pastaj u vazhdua pjesa e dyte

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se para se me e vazhdojmë me pikën, e radhës ka një kërkesë nga sektorët e Kuvendit, për një çështje teknike, materiali te disa anëtarët të Kuvendit po kthehet e-mail, ose i keni të ngarkuara, ose janë në mbyllë disa. Ju kisha lutë, pastroni e-mailat e vjera, ose nëse i keni e-mailat e vjera, i drejtoni te Behari, në mënyrë që me ardhë materiali.

IV

Diskutimi i planit të veprimit të adresimit te rekomandimeve te ZKA-së

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Safet Krasniqit, auditor i mbrëmshëm , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se nga këto rekomandime te auditorit sa keni mujt me i përmirësuar këto rekomandim e dhe a jeni duke pranuar qe këto rekomandime te përmirësohen.

Safet Krasniqi, tha se nga vetë rekomandimet edhe në raportin e auditimit prej tyre 6 janë rekomandimet përsëritura. Nga ato se janë zbatuar, janë 4 prej tyre domethënë që janë në proces apo që nuk kanë arritur të zbatohen. Problemi pse kemi rekomandime të zbatuar është një problem që është trajtuar në nivele në takimeve që kemi pasë në Zyrën Gjenerale edhe me mekanizma të tjerë. Janë rekomandime që kanë të bëjnë me që po krijuar nga vetë sistemi apo mënyra se si funksionojnë na si shtet.

Arsim Jashari, tha se dua mi ngrit dy çështje: e keni pasë një rekomandim nga auditori i jashtëm për bursat që e keni zbatuar, pse nuk jua keni dhënë mundësinë studentëve që studiojnë jashtë vendit me kanë pjesë e fitimit të bursë. Rekomandimi i auditorit të jashtëm u ka dhanë të drejtën, nuk ka nevojë më justifikuesit të certifikojnë atyre, nuk justifikohen, e keni aty e keni përshkrimit, kësaj radhe ju e keni bërjen e

bursave, por nuk janë parapa brenda studentëve që studiojnë jashtë vendit domethënë. Ju po thoni që e kena zbatuar rekomandimin e auditorit të obligimet, mësuesve, se kjo po na vjen neve çdo vjet. Ne e dimë që s'kemi linjë buxhetit për me i paguar mësuesit. E di shumë mirë se kur u bë marrëveshja kolektive, nuk ju kanë vënë komunitat hiç.

Alban Salihu, tha se veç po dua me thënë që është shumë e rëndësishme qëto rekomandime, kur vlerësohen si të zbatuara. Unë e përmenda shumë shkurt, veç të dy rekomandimet e para që po shkruan që janë të zbatuara. Ne kemi identifikuar se në konkursin për plotësimin e vendeve të punës për dy mjekë të nuk ishte bërë përzgjedhja e kandidatëve sipas rezultate të treguara në testin me shkrim të intervistës. E shkolla e zbatimit të rekomandimit po thotë rekomandimi është i zbatuar. Ne në pikën e parë ë jashtë rendit të ditës diskutuam për rrjedhjen e një testi që ka ndodhur domethënë realisht gjendja faktike nuk e pasqyron Nuk e pasqyron qitu që është rekomandim i zbatuar për shkak që gjendja në institucion nuk është ndryshuar. Ne kemi pasë atëherë një konkurs të pa të padrejtë dhe tash njëjtë na kanë rrjedhë pyetjet, ku po e dëshmon që nuk kemi ndonjë ndryshim. Edhe te e dyta, që e përmendi Arsimi në konkursin për vitin akademik për ndarjen e bursave, që shkelet që u bë në aplikimin e bursave, po thotë që rekomandimi është zbatuar, por është e rëndësishme me ditë qysh është zbatuar. Po dua me thënë që nuk ka nuk ka përmirësim përmbajtjesor, po vetëm teknik.

Safet Krasniqi, tha se po bëj një përmbledhje, meqenëse i kemi atë prezant edhe drejtor të Drejtorive të caktuar, ju treguam fillimisht që informata për rishikimin edhe vlerësimin është bërë në bazë të përgjigjeve që e kemi marrë nga drejtoritë edhe dokumentacioni që na ka shkruar. E dyta te bursa sa që e potencova, po të thotë se atyre na bazuar se ka qenë një jem për certifikim për dokumentacion të justifikime dhe është eliminuar, në ndonjërin një kërkesë e tillë është eliminuar dhe ne e kena marrë se informatika deri në DKA-ja, se është një rregullore e re, që e ka evituar një situatë të tillë të paraqitet. E dyta sa i përket konkursit që e përmenda në Shëndetësi, fillimisht në fillim ku u fillua prezantimi, u tha se ne i kemi dy rishikime që do të provojnë gjatë vitit. Vitin e kaluar kanë bë një vlerësim, vlerësimi i dytë i ka qenë identik me vlerësimin që na ka ana në raportin e keni pa kur e keni ra raportin e Zyrës Kombëtare, sepse na jena nis për arritje të konservatizmit që të mos bërë vena me bo vetë dit që do të bëhet një vlerësim i drejtë i rekomandimeve për shkallën sa a janë zbatuar.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua ne piken në vazhdim

V

Diskutimi i raportit të auditorit të brëmshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safet Krasniqi auditor i brendshëm i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua në piken e vazhdim

VI

Propozim vendim për caktimin e veprimeve të përkohshme për trajtimin e objekteve të mbyllura shkollore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasnait drejtor i DKA i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha sikur do të ishte bërë regjistrimi i popullsisë situata do të ishte ndryshe ato objekte duhet të ruhet dhe nuk duhet të lejohet të dëmtohen dhe ato objekte është mirë që po i drejtohen për mirëmbajtje këshillit të fshatit apo dikujt tjetër, sepse në të kundërt do të dëmtoheshin. Në grupin e PDK-së e mbështesim këtë propozim vendim.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se e kam parasysh se sot ne po diskutojmë më shumë për kalimin e objekteve shkollore në përgjegjësi të Këshillat të Fshatrave, që është një iniciativë mjaft e mirë, sepse ruhet institucioni nga se na ka ndodhë që institucionet janë shkatërruar për shkak që nuk kanë pasur mbikëqyrje, por meqë është si temë mbyllja e këqyrjeve paralele, do më shfrytëzoj rastin me të bëj një pyetje, Po më intereson mbyllja e këtyre paraleleve a janë sistemuar dikun dhe nëse në të ardhmen mbyllen prap, sepse ne kemi informata që në të ardhmen mundet me që do të më u mbyll paralele, a do të ruhet vendet e punës, sepse me mbet pa punë do të ishte shumë shumë e randë.

Bashkim Budakova, tha se sa i përket këtij propozim vendimi është mirë qe po i kalon këshillit me qëllim të mos dëmtimit dhe të shkatërrimit të tyre objektive shkollore. Unë kam një pyetje për objektin e vjetër të shkollës fillore, Drita në Rubovc, të cilët e kanë kryer edhe në shkollën fillore: a kemi ndonjë vendim të shkruar apo të pashkruar apo, së paku të menduar për gjendjen e atij objekti, ku një pjesë e saj përbehet nga minoriteti ndërsa pjesa tjetër është në gjendje të mjerë?

Fadil Spahiu, tha se e mbështes këtë propozim-vendim për dhënien dhe menaxhim të përkohshëm të këtyre tri objekteve shkollore, këshillave të fshatrave, përkatësisht për përdorim të nevojave e arsyeshme të fshatrave dhe karakterit të përgjithshëm, sepse mendoj se, meqë kanë mbetur kështu këto objekte, vërtet do të dëmtohen.

Nexhemdin Lekiqi, tha se kisha pasë veç një kërkesë nëse mundemi drejtoria apo dikush me e përpiluar një draft, një rregullore, me të cilën i qesim disa korniza se çka mund të përdoret ajo shkollë. Deri diku na po ia dorëzojmë, ne as po i mësojmë edhe çka me përdorë, por janë disa gjana të cilat janë të pranueshme e disa gjana që nuk janë të pranueshme. Kështu që kam si propozim që ndoshta duhet mu ulë dikë ajo me bere një draft, një statut lidhur me këto objekte

Alban Salihu, tha se vendimi si vendim edhe mundet me kanë në rregull, por a e shqetëson dikë këtu shkaqet dhe arsyet pse kanë mujt me ardhë një vendim i tillë. Një qytet si Lipjani me një shtrirje gjeografike në mes të shtetit kështu në mes të rrafshit të Kosovës, nuk është ne rregull A ndihemi përgjegjës që e kemi dërguar infrastrukturën e nevojshme si institucione në këto fshatra? Na kemi folë këtu në një nga seancat e kalume edhe për kualitetin e arsimit nëpër fshatra. A ndjehemi përgjegjës për nivelin e arsimit që kemi dërguar në këto fshatra dhe çka i ka shty banorët që të që të bëjnë lëvizje të tilla, ku me siguri për shkak të numrit të vogël të banorëve dhe shkollat ashti po mbesin edhe qysh e tha edhe parafolësi Kjo është veç në fillim i një cili që mundet me vazhduar dhe po kena përqendrim në disa shkolla, e ku për shkak të përqendrimit të madh pastaj edhe kualiteti këtu po vihet në pikëpyetje për shkak të kushteve që mujna me i afri edhe si hapësirë, po edhe si edhe si kualitet nga ligjëruesit, nga mësuesit që e ligjërojnë atë.

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha se përgjegjës jemi ne të gjithë, pra problemi është i përgjegjshëm, faji është i përgjegjshëm, faji është i gjithëve i përbashkët, a ka mundësi ajo për me zgjidhë shumë të ardhmen nuk e di por kështu është duke t shkuar trendi.

Egzona Bytyqi, tha se ne ë e kemi para vetes një propozim-vendim që ka ardhë si pasojë e shpërnguljes të fshatrave, e që realisht unë mendoj që është momentum që si nivel lokal, si qytetarë edhe si Qeveri, të kemi një bashkëpunim të sinqertë edhe me menduar që me gjetë zgjidhje inovative se si me kthyer interesin edhe jetëgjatësi në fshatra. Tjetra, çka mendoj me nxjerrë nga projekti Propozim-vendimi është që komuna jonë, është ngarkua jashtëzakonisht shumë, edhe në aspektin e transportit të këtyre nxënësve. Sa i përket asaj, unë mendoj që edhe struktura këtyre shkollave, mund me shfrytëzuar besoj që për aktivitete të ndryshme, siç shihet që nuk e cenojnë rendin në përgjithësi për aktivitete kulturore trajnime të veçanta ndryshe.

Arsim Jashari, tha se fillimisht na duhet me ditë që shpërngulja, ikja masive e qytetare prej Kosovës ky o ndikimi i parë. Ndikimi i parë ka me vërejte te shkollat e mbasi andej ka me shkruar te punësimet, se po dal jashtë temës, në fakt po dua të mos dal jashtë teme. Në nivel lokal çka jetë me siguruar transportin, me postë nëse ka vena të lira që ta mësim me qu mi zhvendose, përndryshe nuk me mujt me pastë asnjë problem.

Rasaim Hasani, tha se ne këto objekte i kemi për propozim qe këto objekte te ua kalojmë ne menaxhim te këshilla te fshatrave me qellim qe këto objekte mos te dëmtohen, Shkollat te cilat janë mbyllur stafin mësimore e kemi transferuar diku tjetër nuk janë mbet pa punë

Nexhmednin Lekqiqi, tha se në atë nivelin lokal çka mundem me bërë, pse dy prindër nuk jetojnë ne qytet fëmijë bijë ne qytet. Kjo do një studim të shkurtër, duhet ne nivel komune na me ndikuar se është globale, ne duhet me menduar me hulumtuar pse po vjen deri te kjo. Krejt në rregull këta që jetojnë në Lipjan, që vijnë si banorë të Lipjanit, por ata që janë në fshat edhe më kanë pak enigmë se po na ikin.

Gazmend Qerkini, tha se shpresojmë qe nuk do te kemi edhe shkolla tjera qe do te mbyllen por te jene vetëm këto, është mire qe po ju lejohet këshillin ne mënyre qe mos te dëmtohet si objekt.

Rasim Hasani, tha se ne si drejtori as shkolla nuk mund ti ndalim pasi qe prindërit e dëshmojnë me dokument qe janë banore te Lipjanit dhe me këtë nuk mund te bëjmë asgjë.

Arsim Jashari, tha se është mire qe me e ndryshua vendimin pasi qe po behën investime ne fshatra për rini për aktivitete dhe ata po vijnë ne qytet dhe me këtë duhet me i ndryshuar kriteret për me regjistruar nxënësit ne shkolla te qytetit.

Daut Azemi, tha se e di që është shqetësuese çështja që po e diskutojmë, mirëpo vendimi ka të bëjë për diçka që më tani është një vendim. Ideja është që këto objekte me i rujtë edhe ideja e drejtorisë që prapë të ekzekutivit ka qenë ideja më e mirë në këtë situatë për me ia dhënë me një marrëveshje këshillit të fshatit. Për të ardhmen, sigurisht që do të gjithë bashkë me diskutuar, ndoshta është çështje ligjore.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se unë thashë që ta konsumojmë këtë temë mirëpo, drejtori disa herë ka thënë atë që e tha që po kanë bazë ligjore që po i regjistrojnë fëmijët në shkolle. Në e dimë që ka familje jeton afër xhamisë atje, edhe i bijnë fëmijët në qytet. Është një komision atë që e vendos. mirëpo unë mendoj që komuna duhet me qenë më rigoroz. Ai komision duhet me qenë shumë rigoroz ku pranon mirë nxënësit nga jashtë kriterëve, sepse po ka klasë në 40 nxënës.

Fitim Mëziu, tha se të gjithë ne, na do të kishim pasë dëshirë që atje të kishim nxënës, mirëpo vendimi mendoj që është i qëlluar, pasi që është një aset komunal shoqëror dhe qëllimi është me e rujtë atë objektin. Çështje tjera domethënë mund t'i diskutojmë në një temë të veçantë, kjo është ajo që deshta me e theksuar

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për 6 kundër, 5 abstenim aprovoi propozimin

VII

Propozim vendim për miratimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Daut Azemi, tha se është propozuar nga doktoresha e Egzona e të behet pritja e mërgimtarëve sidomos kur është mërgata ftesë edhe festivali që e kenë ata zyrtarë. Unë kisha propozua që të jetë muaj në korrik, Edhe një vizitë studimore të cilën e ka propozua, më herët, Propozoj ose a keni propozim t'i lejojmë muajin prill-maj apo shtator-tetor ose lejojmë fillim tani gjatë vitit, unë po kam kam diskutuar edhe me kryetarin ë dëgjo kam diskut kam diskutua edhe me kryetarin edhe sot, prapë e kam përsërisë ë do të provojmë që me bojë do të provojmë, por kryetarin na ka dhënë mbështetje që ta bëjmë një vizitë si Kuvend, dy-ditore.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se po shtim në plan për muajin prill, edhe shohim kurdo që ne jemi gati a e mujm në prill ose në maj, ose në tetor, është çështja që do ta bëjmë, por po fusim në plan që të jetë si propozim.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se komuniteti për komitete e pat bere një raport por nuk e pat qit ne kuvend pse?

Daut Azemi, tha se ne janar ose ne shkurt e kam lënë qe te jenë raportet e komuiteteve.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:45.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi